

“ Fakulteti ynë ofron qasje në mundësi të ndryshme të ngritjes në karrierë për të rinj dinamikë dhe kreativë. Pjesa dërmuese e programeve të ofruara janë unike, të paofruara në institucione të tjera të arsimit të lartë. ”

## Pranimet

Pranimet në Universitetin e Prishtinës bëhen nëpërmjet konkurseve publike. Çdo person i cili e ka përfunduar maturën shtetërore dhe i përmbush kriteret e përcaktuara në konkursin për studentë të rinj, ka të drejtë të konkurrojë për t'u bërë pjesë e Universitetit tonë. Përmes një procesi të hapur dhe konkurrues, ju do të mund të bëheni pjesë e universitetit lider në vend.



## Rreth nesh

Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore është qendra kryesore studimore dhe kërkimore në fushën e shkencave të natyrës. Ky fakultet, i njohur për traditën disa dekadash në formimin e kuadrove të rinj në shkencat ekzakte, tërheq të rinjtë që dëshirojnë të studiojnë në programet atraktive dhe bashkëkohore për biologji, kimi, fizikë, shkenca kompjuterike, gjeografi, ekologji, matematikë financiare e programe të tjera të ndërlidhura.



## Kontakti

Adresa:  
Rr. "Nëna Terezë" p.n. 10 000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Telefoni:  
+383(0)38 249 872/ 249 873/ 249 874  
Fax. +383(0)38/226-104  
Email:  
fshmn@uni-pr.edu  
Webfaqja  
<https://fshmn.uni-pr.edu/>



# Fakulteti i Shkencave Matematikë- Natyrore

# Kalendari akademik

|                      |   |
|----------------------|---|
| 15 janar             | Përfundimi i ligjëratave (semestri dimëror) |
| 15 janar – 15 shkurt | Provimet e semestrit dimëror                |
| 15 shkurt            | Dita e Universitetit të Prishtinës          |
| 16 shkurt            | Fillimi i semestrit veror                   |
| 31 maj               | Përfundimi i ligjëratave për vit akademik   |
| Korrik               | Konkursi për studimet bachelor              |
| Shtator              | Konkursi për studimet master                |
| 15 shtator           | Përfundimi i vitit akademik                 |
| 1 tetor              | Fillimi i vitit akademik                    |

## Programet:

### Bachelor

Biologji (180 ECTS)  
Kimi (180 ECTS)  
Kimi Inxhinierike (180 ECTS)  
Kimi Ushqimore (180 ECTS)  
Shkenca Kompjuterike (180 ECTS)  
Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit (180 ECTS)  
Matematikë Financiare në Banka dhe Sigurime (180 ECTS)  
Gjeografi (180 ECTS)  
Fizikë (180 ECTS)  
Matematikë (180 ECTS)  
Biologji Molekulare (180 ECTS)

## Pse n'FSHMN?

- Programe studimore atraktive;
- Profesorë me përvojë dhe eminentë në fushat përkatëse;
- Tarifa të ulëta studimi;
- Mundësi të shumta për shkëmbime njësemestrale në universitete evropiane dhe botërore;
- Diplomë e njohur ndërkombëtarisht;
- Kampusi në qendër të kryeqytetit;
- Laboratorë bashkëkohorë;
- Partneritete të shumta me tregun e punës, të cilat krijojnë mundësi për: punë praktike, vende pune dhe ngritje në karrierë;
- Bursa për studentët me arritje të larta;
- Mjedis akademik stimulues, i cili inkurajon rritjen intelektuale.

### Master



Kimi Analitike dhe Kimi Mjedisore (120 ECTS)

Biologji (120 ECTS)

Shkenca Kompjuterike (120 ECTS)

Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit (120 ECTS)

Gjeografi (120 ECTS)

Kimi Organike (180 ECTS)

Kimi Fizike dhe Kimi Inorganike (180 ECTS)

Fizikë (180 ECTS)